



Planuar / Doretuar Printim/Prodato Received/Delivered	18. 12 2020	viti god year	0
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMJHCK	3195/2020		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.346/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.346/2020 të datës 05.11.2020 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED], kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si bazuar ankesa numër A.nr.346/2020 e datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

II. SHFUQIZOHET Vërejtje me shkrim e datës 28.10.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe të gjitha vendimet tjera që rrjedhin nga vërejtje me shkrim.

III. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke ju bërë largimi i vërejtjes me shkrim nga dosja personale e ankueses.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED], e punësuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në vendin e punës “Zyrtare për procesimin e të dhënave”, në Drejtorinë e Drejtoratit të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve.

Me datë 28.10.2020 Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve, përmes formës elektronike (E-mail) i ka shqiptuar “*vërejtje me shkrim*”, ankueses lidhur me sjelljen e pa hijshme dhe dallimit të madhe të lëndëve të pa kryera në raport me kolegen e saj.



Ankuesja e pa kënaqur me masën disiplinore të shqiptuar *"Vërejtje me shkrim"*, të datës 28.10.2020, ka parashtruar ankesë me datë 05.11.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër 2453/2020, me pretendimet ankimore se vërejtja me shkrim i është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 12.11.2020 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve. Me datë 18.11.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 2453/2020 të datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 28.10.2020; E-mail i datës 27.10.2020; Akt emërimi i datë 01.10.2012; Ndryshim plotësim të Akte emërimit të datës 14.08.2017; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimi nr.2237 i datës 25.09.2019; Vendimi nr.1761 i datës 17.09.2019; E-mail i datës 29.10.2020; E-mail i datës 27.10.2020; Kërkesë për provë shtesë e datës 08.12.2020; Prove shtese e datës 09.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses ██████████ është e bazuar, **SEPSE**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankueses e cila pretendon se ndaj saj është shqiptuar *"Vërejtje me shkrim"*, me datë 28.10.2020, lidhur me sjelljen e pa hijshme dhe mos kryerjen e lëndëve në punë e cila ka dallim të madhe në raport me kolegen e saj, nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë të qëndrueshme, sepse me datë 28.10.2020 Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ndaj ankueses Sherife Ramadani ka shqiptuar masën disiplinore *"Vërejtje me shkrim"*, i cili ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore duke rënë ndesh me dispozitat ligjore të nenit 48 paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: **"Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"** sepse shqiptimi i masave disiplinore shqiptohet duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 i Rregullores (QRK)Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: **"1. Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe 1.2. Komisioni Disiplinor"**, e jo siç ka vepruar Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, i cili nuk është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, kolegji ka marrë për bazë këto rrethana si njëri ndër arsyt kryesore që ka aprovuar ankesën e ankueses, si dhe duke u bazuar në përgjigjen e njësisë së personelit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të datës 09.12.2020 ku ka vërtetuar se ankuesja i raporton Sektorit për Procesimin e të Dhënave tek Udhëheqësi i Drejtorit, të përcaktuar në nenin 70 të Rregulloren Nr.29/2012 për organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, e cila është në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË
KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.346/2020



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajëse

Vendimi i dërgohet:

Ankueses [REDACTED]

Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve,
Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve,
Arkivit të KPMSHCK-së.